279/20
29.06.2020

PSH .nr. 279/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068,dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të: z. Blerim Dina - Kryetar z. Nuhi Paçarizi - Referues, z. Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: OE "D&T Group shpk & Florida shpk. & Horn 7 Co Kosova shpk"-Gjakovë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë operatori ekonomik: SH. Drini Company SH.P.K.; BERISHA COM SH.P.K-Prizren, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ri-shpallje Mirëmbajtja e autorrugëve Pjesa e I-rë –Mirëmbajtja dimërore e rrugëve urbane" me nr. të prok: 632-19-7809-2-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna Gjakovë, më datën: 26.06.2020, mori këtë:

V E N D I M

I.APROVOHET, si pjesërisht e bazuar ankesa e operatorit ekonomik "D&T Group shpk & Florida shpk. & Horn 7 Co Kosova shpk"-Gjakovë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ri-shpallje Mirëmbajtja e autorrugëve Pjesa e I-rë –Mirëmbajtja dimërore e rrugëve urbane" me nr. të prok: 632-19-7809-2-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna Gjakovë.

II.ANULOHET, njoftimi për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ri-shpallje Mirëmbajtja e autorrugëve Pjesa e I-rë –Mirëmbajtja dimërore e rrugëve urbane" me nr. të prok: 632-19-7809-2-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna Gjakovë. Dhe Lenda kthehet ne **Rivleresim.**

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV .Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues "D&T Group shpk & Florida shpk. & Horn 7 Co Kosova shpk"-Gjakovë, aprovohet pjesërisht si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI .Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Operatori ekonomik ankues OE "D&T Group shpk & Florida shpk. & Horn 7 Co Kosova shpk"-Gjakovë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me 05.05.2020 me nr. 279/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ri-shpallje Mirëmbajtja e autorrugëve Pjesa e I-rë –Mirëmbajtja dimërore e rrugëve urbane" me nr. të prok: 632-19-7809-2-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna Gjakovë, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin: 1, 6, 7, 51, 52, 56, 59, 60 dhe nenin 72 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 13.05.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 10.06.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim: PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES "D&T Group & Florida".

Përgjigje në pretendimin nr.1, Lidhur me pretendimin e parë ankimorë mbi arsyet e eliminimit të OE ankues, AK-KK Gjakovë me rastin e rivlerësimit konform rekomandimeve të ekspertit shqyrtues dhe vendimit të panelit shqyrtues nr.933-952/19 ka kërkuar sqarime shtesë nga OE ankues, dhe pas pranimit të përgjigjeve/sqarimeve AK-komisioni vlerësues ka vlerësuar se OE nuk plotëson kërkesat e dosjes sa i përket kontratave për punë të natyrës së ngjashme në tri vitet e fundit si dhe nuk plotëson kërkesat për pajisje.

Pas analizimit të raportit të komisionit rivlerësues dhe ofertës së OE ankues, vlerësojmë se OE ankues nuk plotëson kërkesat minimale sa i përket punëve të ngjashme në tri vitet e fundit. Nga lista e projekteve të ofruar nga OE ankues në ofertën e tij, shumica e projekteve nuk janë të natyrës së ngjashme me natyrën e

kësaj kontrate dhe OE nuk e arrin vlerën e kërkuar prej 350,000€. Bazuar në gjitha këto që u cekën si më lart vlerësojmë se pretendimi ankimorë në këtë pikë është i pabazuar. Gjitha detajet tjera lidhur me plotësimin e kërkesave minimale nga OE ankues gjenden në raportin e komisionit vlerësues të shënuar më lart.

Përgjigje në pretendimin nr.2, Lidhur me pretendimin ankimorë të OE ankues kundrejt OE të rekomanduar për kontratë, pretendimi kryesor është se OE i rekomanduar për k-ontratë të njëjtën makineri ka ofruar në të dy lotet dhe kështu e ka të pamundur realizimin e kontratës. Pas analizimit të ankesës, dosjes së tenderit, dhe ofertës së OE të rekomanduar për kontratë, fillimisht sqarojmë se me rastin e ritenderimit janë zvogëluar kërkesat për kapacitet teknik/Professional sa i përket pajisjeve/makinerisë. Me rastin e ritenderimit nga 11 kamion sa ishin kërkuar me rastin e publikimit të parë, tani në dosje janë kërkuar gjithsej 6 kamion. Ndërsa edhe për lot.2 të për të cilin ka nënshkruar kontratë OE janë kërkuar 6 kamion, që në total i bie se nevojiten 12 kamion për plotësimin e kërkesave të AK-së për të dyja lotet. Pas analizimit të ofertës së OE të rekomanduar për kontratë, nga listat e pajisjeve që ka ofruar OE janë gjithsej 15 kamion. Do thotë në qfardo rrethane OE i rekomanduar për kontratë e plotëson kërkesën e AK-ë. Po ashtu nga 3 pastrues bore mini, sa ishin kërkuar herën e parë për lot.1, tani kërkohen vetëm 2, ndërsa në ofertë të OE të rekomanduar për kontratë i njëjti ofron 5 pastrues bore mini. Bazuar në gjitha këto që u cekën më lartë vlerësojmë se pretendimi ankimorë edhe në këtë pikë është i pabazuar.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të refuzohet e pabazuar, ndërsa të vërtetohet vendimi i AK-së njoftimi për dhënie të kontratës.

Autoriteti Kontraktues, me datë: 11.06.2020, me anë të shkresës zyrtare është njoftuar nga OSHP lidhur me mendimin e ekspertit shqyrtues, mirëpo i njëjti nuk ka kthyer përgjigje.

Operatori Ekonomik, me datë: 12.06.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 26.06.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit profesional të prokurimit, dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron ankesa është parashtruar kundër njoftimit për dhënie të kontratës.

Lidhur me pretendimin ankimor mbi arsyet e eliminimit të OE ankues, paneli shqyrtues konform mendimit të ekspertit shqyrtues të OSHP-së, sqaron se gjatë ri-vlerësimit AK-KK Gjakovë, konform vendimit të panelit shqyrtues nr.933-952/19, ka kërkuar sqarime shtesë nga OE ankues, dhe pas pranimit të sqarimeve nga ata, komisioni vlerësues i autoritetit kontraktues ka vlerësuar se OE nuk plotëson kërkesat e dosjes sa i përket kontratave për punë të natyrës së ngjashme në tri vitet e fundit si dhe nuk plotëson kërkesat për pajisje.

Paneli shqyrtues sqaron se kërkesa e Autoritetit Kontraktues te publikuar ne njoftimin per kontrate dhe dosje te tenderit është si me poshtë:

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale; 9.1 & 9.2 tek ***Kapaciteti teknik dhe professional:*** Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së ngjajshme në 3 (tri) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për kontratë. Në një vlerë prej jo më pak se 350.000,00€, në rast konsorciumi lideri duhet të ketë të paktën 60% kontrata të natyrës së ngjajshme. ***Dëshmia e kërkuar dokumentare*** Lista e kontratave të realizuara në 3 (tri) vitet e fundit, duke saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje të shërbimeve

Paneli shqyrtues sqaron se pas analizimit të raportit të komisionit rivlerësues dhe ofertës së OE ankues, Operatori ekonomik ankues ka dorëzuar një liste me 25 projekte pranë AK-së te përfunduara ne periudhën e kërkuar, vete kërkesa e AK-se siç shihet me larte është kontrata te natyrës se ngjashme e jo kontrata te natyrës se njëjtë, Obligohet AK qe gjatë rivlerësimit te merr parasysh te gjitha kontratat e ngjashme te operatorit ekonomik për punët e realizuara gjate periudhës se kërkuar, gjithashtu sipas nevojës, te kërkoj sqarime shtese edhe për situacionet e përfunduara për periudhën e kërkuar, se a e plotëson kërkesën e AK-se ne vlerë prej 350,000.00€ OE ankues.

Lidhur me pretendimin ankimor të OE ankues kundrejt OE të rekomanduar për kontratë, se OE i rekomanduar për kontratë të njëjtën makineri ka ofruar në të dy lotet dhe kështu e ka të pamundur realizimin e kontratës, paneli shqyrtues pas analizimit të ankesës, dosjes së tenderit, dhe ofertës së OE të rekomanduar për kontratë, paneli shqyrtues sqaron se me rastin e ritenderimit janë zvogëluar kërkesat për kapacitet teknik/professional sa i përket pajisjeve/makinerisë nga autoriteti kontraktues.

Paneli shqyrtues, me tej sqaron se me rastin e ritenderimit nga njëmbëdhjetë (11) kamion sa ishin kërkuar me rastin e publikimit të parë, tani në dosje janë kërkuar gjithsej gjashtë (6) kamion. Ndërsa edhe për Lot 2 të për të cilin ka nënshkruar kontratë OE janë kërkuar gjashtë (6) kamion, që në total i bie se nevojiten dymbëdhjetë (12) kamion për plotësimin e kërkesave të AK-së për të dyja lotet. Gjatë analizimit të ofertës së

OE të rekomanduar për kontratë, vërehet se nga listat e pajisjeve që ka ofruar OE i rekomanduar janë gjithsej pesëmbëdhjetë (15) kamion, që do thotë OE i rekomanduar për kontratë e plotëson kërkesën e AK-së, në rastin e ndryshimit të kërkesës gjatë ritenderimit dhe rivlerësimit të ofertave të OE pjesëmarrës. Po ashtu, nga tre (3) pastrues bore mini, sa ishin kërkuar herën e parë për Lot 1, tani kërkohen vetëm dy (2), ndërsa në ofertë të OE të rekomanduar për kontratë i njëjti ofron pesë (5) pastrues bore mini.

Paneli shqyrtues vjen në përfundim se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë konform nenit 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe neni 60 i LPP-së kriteri kryesor për dhënie të kontratës e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët.

Paneli shqyrtues sqaron se autoritetet kontraktuese janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së.

Gjithashtu paneli shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues duhet të ketë në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

z. Blerim DINA

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK- Komuna Gjakovë

1x1 OE -"D&T Group shpk & Florida shpk. & Horn 7 Co Kosova shpk"-Gjakovë

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.